

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit		
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia		
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i operacioneve		
Niveli:	Baçelor		
Statusi i lëndës:	O		
Viti i studimeve:	II		
Semestri:	III		
Numri orëve në javë:	3		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:	USHAF		
Mësimdhënësi i lëndës:			
Detajet kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës	Menaxhimi i operacioneve trajton menaxhimin e funksionit thelbësor të ndërmarrjes, transformimin e inputeve në outpute përmes shërbimeve dhe produkteve. Studentët do të njohin strategjitë dhe teknikat e menaxhimit të operacioneve, duke përfshirë menaxhimin e kapaciteteve, inventarit, cilësisë dhe zinxhirit të furnizimit. Lënda mbështetet edhe në vizita studimore dhe punë praktike për të ndërtuar aftësi reale.		
Qëllimet e lëndës	Të aftësojë studentët për menaxhim efikas të operacioneve në ndërmarrje, duke arritur objektivat e biznesit dhe nevojat e konsumatorëve përmes njohurive teorike dhe praktikës.		
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të këtij moduli, studenti do të jetë në gjendje të: 1. Analizojë dhe kuptojnë proceset e ndryshme të operacioneve, (ECTS 1), 2. Planifikojë dhe kontrollojnë aspektet e operacioneve sikurse janë kapaciteti, inventari, cilësia, etj. (ECTS 1), 3. Kuptojë procesin e dizajnit të produktit dhe proceseve të operacioneve, (ECTS 1), 4. Kompetent në hartimin e politikave prodhuese-shërbyese në ndërmarrje, (ECTS 1), 5. Për të kryer një analizë të aktivitetit të punës në ndërmarrje; (ECTS 1),		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)			
Detyra të shtëpisë	1	10	10

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare në provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	5	10
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjërata Kursi zgjat 15 javë me 3 orë leksione dhe/ose ushtrime javore individuale dhe grupore. Ushtrimet do të mbahen në formën e punës individuale dhe grupore në të cilën do të diskutohen shembuj konkretë. Pjesëmarrja aktive është jashtëzakonisht e rëndësishme, kështu që studentët inkurajohen që të ndjekin rregullisht leksione dhe ushtrime dhe të kontribuojnë në diskutimet që zhvillohen në leksione. Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, shembujve praktikë, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohet në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe rasteve studimore, zgjidhjes së detyrave numerike dhe interpretimit të tyre. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndër-vepruese profesor–student si dhe ai student-student.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në baze të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminari..max 20 pikë (%), ➤ Provimi final.....max 60 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: Vijushmërianë mësim (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Aktiviteti (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo më shumë se 3 studentë) duhet të përgatitë një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti		

15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	5
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	5
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	10
Gjithsej:	20

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**35 pikë (%)**,
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....**25 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:

Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm
8	C	70 - 79	Shumë mirë
7	D	60 - 69	Mirë
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm

Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi Tabela inteligjente, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% - Teori, 40% - Ushtrime praktike Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 60% me fokus në teori dhe 40% ushtrime/praktike . • 75 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. • 50 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 60%-40% ▪ 3 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ▪ 2 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike prezantim,
Literatura	
Literatura bazë	1. Suzana Panariti, “Menaxhimi i projektit” Tirane 2017, Adel Co Tiran 2. Slack, N. Chambers, S, Johnston, R (2014). Menaxhim Operacionesh. Ed. Pearson, Autoriteti, Q.F.C. (2010) Operacionet efektive dhe menaxhimi i performancës. Londër: Bloomsbury USA Akademik.
Literatura shtesë	1. Shyqeri Llaci, - “Menaxhmenti” Tirane 2008. 2. Charles W.L Hill and Gareth R. Jones, Strategic Management: An Integrated Approach, 8th edition Without the cases, Houghton Mifflin, 2008. 3. Dr. Sc.Ibrahim Kuka,” Menaxhmenti dhe vendosja afariste” 2006, Prishtinë
<u>Informacion shtesë</u> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	*Punimi shkencor: “Leadership Styles In Kosovo Businesses” Autor: Aziz Rexhepi; Hysen Sogojeva; Besarta Rexhepi; Bislim Lekiqi Technium: Romanian journal of applied sciences and technology (issn: 2668-778X) Vol.2 issue4, page 68-79 https://www.ebscohost.com/titlelists/e5h-coverage.htm
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezentimi i syllabusit & Menaxhimi i operacioneve – hyrje Prezantim i lëndës, konceptet bazë dhe historiku i menaxhimit të operacioneve Njohje me konceptet bazë dhe rëndësinë e menaxhimit të operacioneve. Rezultati i pritur nr. 1.

Java e dytë	Menaxhimi i resurseve njerëzore Rekrutimi, seleksionimi, motivimi dhe komunikimi në kuadër të operacioneve Analizim i menaxhimit të burimeve njerëzore në operacione. Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2.
Java e tretë	Strategjia e operacioneve IA: Strategjia dhe teknologjia në operacione Lidhja e strategjisë së operacioneve me atë të biznesit, rast studimi. Kuptim i strategjisë dhe ndikimit të saj në operacione. Rezultati i pritur nr. 2.
Java e katërt	Menaxhimi i kapaciteteve Planifikimi dhe kontrolli i kapaciteteve, menaxhimi i kërkesës. Planifikim efektiv i kapaciteteve për përmbushje të kërkesave. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e pestë	Zhvillimet teknologjike Aplikimi i teknologjisë në prodhim dhe shërbime, vizitë studimore në kompani. Vlerësim i ndikimit të teknologjisë në operacione. Rezultati i pritur nr. 2 dhe 3.
Java e gjashtë	Menaxhimi i inventarit IA: Kontrolli dhe optimizimi i inventarit në organizata Roli dhe menaxhimi i inventarit, avantazhet dhe disavantazhet. Menaxhim efektiv i inventarit për optimizimin e proceseve. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e shtatë	Praktika operative Vizita studimore, vizitë në kompani e regjionit të Ferizajt për të parë praktikatat operative. Aplikim i teorisë në praktikë dhe njohje me proceset reale operative. Rezultati i pritur nr. 3 dhe 4.
Java e tetë	Planifikimi kohor dhe realizimi Sekuencimi, planifikimi i aktiviteteve dhe monitorimi i tyre Hartim dhe kontroll i planit kohor të operacioneve. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e nëntë	Menaxhimi dhe dizajnimi i vendeve të punës Projektimi i sistemit të punës dhe analiza e metodave të punës Hartim i vendeve të punës që përmirësojnë efikasitetin dhe cilësinë. Rezultati i pritur nr. 3 dhe 4.
Java e dhjetë	Planifikimi dhe kontrolli i projektit Rëndësia e planifikimit, monitorimi dhe kontrolli i operacioneve. Menaxhim efektiv i projekteve dhe operacioneve. Rezultati i pritur nr. 3 dhe 4.

Java e njëmbëdhjetë	Menaxhimi i cilësisë Koncepti dhe standardet ISO, teknikat për arritjen e cilësisë. Kuptim i teknologjive të cilësisë dhe standardeve të njohura. Rezultati i pritur nr. 3 dhe 5.
Java e dymbëdhjetë	Menaxhimi i zinxhirit furnizues Koncepti dhe menaxhimi i zinxhirit furnizues, vendimmarrja të-bëj-apo-të-blej. Menaxhim i zinxhirit furnizues për përmirësim të efikasitetit. Rezultati i pritur nr. 5.
Java e trembëdhjetë	Natyra dhe qëllimi i projektimit Llojet e proceseve të prodhimit dhe shërbimeve, lidhja e projektimit të produktit. Kuptim i projektimit të proceseve dhe ndikimit në produkt.
Java e katërbëdhjetë	Stilet e Lidërshpimit - Bizneset e Kosovës (nga punimi shkencor) Rezultati i pritur nr. 5.
Java e pesëmbëdhjetë	Aftësi prezantuese dhe përmbledhje kritike e njohurive të fituara Prezantimi i punimeve dhe diskutimi i temave të zhvilluara gjatë kursit. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	